



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
ZËVENDËSKRYETARI

Nr. 1854 Prot.

Tiranë, më 03/06/2021

NJOFTIM

për hapjen e procedurës së aplikimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese

Bazuar në nenin 125, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, tre anëtarë të Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Në zbatim të kësaj dispozite kushtetuese, rregullimi që bën neni 7/ç, pika 1 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton detyrimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese për t’i njoftuar vendin vakant Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili shpall hapjen e procedurës së aplikimit në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka njoftuar për 3 vendet vakante, të krijuara sipas ligjit, përkatësisht:

1. për përfundimin e mandatit 9 vjeçar të Znj. Vitore Tusha, në datë 10 mars 2017, e emëruar në mars të vitit 2008; Njoftimi është bërë në datën 09.01.2017,
2. për përfundimin e mandatit të Z. Fatmir Hoxha në datë 25 shtator 2018, për shkak të shkarkimit nga detyra me vendim të formës së prerë, i emëruar në vitin 2011; Njoftimi është bërë në datën 27.09.2018,
3. për përfundimin e mandatit të Z. Gani Dizdari në datë 22 prill 2019, për shkak të shkarkimit nga detyra me vendim të formës së prerë, i emëruar në vitin 2013; Njoftimi është bërë në datën 14.02.2019.

Pas këtyre njoftimeve, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka bërë shpalljen publike për plotësimin e vendeve vakante, në datat 16.01.2017, 21.11.2018 dhe 19.04.2019. Për të tri thirrjet ka rezultuar paraqitja e numrit të pamjaftueshëm të kandidaturave, gjë e cila është bërë shkak për moszhvillimin e procedurave të mëtejshme nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me qëllim plotësimin e vendeve vakante të Gjykatës Kushtetuese, nga Gjykata e Lartë.

Për këto arsye, në zbatim të ligjit nenit 7/ç, si edhe të rregullimit të ri që është bërë në nenin 86 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në cilësinë e ushtruesit të kompetencave të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, bazuar nenit 26, pika 2 të ligjit nr. 98/2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor

në Republikën e Shqipërisë”, rishpall hapjen e procedurës së aplikimit të kandidatëve për tri vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, që duhet të plotësohen nga Gjykata e Lartë.

Bazuar në nenin 179, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon skemën për përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet përcaktimit të mandatit për dy gjyqtarët e zgjedhur që do të qëndrojnë në detyrë, përkatësisht deri në vitin 2025 dhe deri në vitin 2028, si dhe referuar nenit 7/dh të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, që parashikon se në rast të përfundimit të mandatit të gjyqtarit para afatit, gjyqtari i ri qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar, shpallja e vendeve vakante si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese bëhet si më poshtë:

1. Në vendin vakant që krijohet pas largimit të znj. Vitore Tusha (mandati i plotë 9 vjeçar i së cilës ka mbaruar në vitin 2017), zgjidhet gjyqtari i ri, i cili qëndron në detyrë deri në mars të vitit 2025;
2. Në vendin vakant të krijuar pas largimit të z. Fatmir Hoxha (mandati i plotë 9 vjeçar i të cilit ka mbaruar në vitin 2020), zgjidhet gjyqtari i ri, i cili qëndron në detyrë deri në muajin qershor të vitit 2028;
3. Në vendin vakant të krijuar pas largimit të z. Gani Dizdarit (mandati i plotë 9 vjeçar i të cilit mbaronte në vitin 2022), zgjidhet gjyqtari i ri, i cili qëndron në detyrë deri në muajin mars të vitit 2022.

Afati i pranimit të kërkesave të kandidatëve është 30 ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Pas përfundimit të këtij afati, Gjykata e Lartë i përcjell Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të emërimit të tyre në Gjykatën Kushtetuese.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që të vërtetojë plotësimin e kushteve dhe kriterëve që parashikon neni 7/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, i ndryshuar, si vijon:

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;

b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;

c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

Lista e kandidatëve do të bëhet publike në faqen web të Gjykatës së Lartë, me qëllim që institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë t'u jepet mundësia të paraqesin pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat.

ZËVENDËSKRYETARI

SOKOL SADUSHI

